



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:185309

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05603302

P.nr.42/2023

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sadri Krasniqi, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, në çështjen penale kundër të pandehurit A.I. A. nga fsh. Parallovë, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale: Vjedhje pylli nga neni 349 parag. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1286/2023, të datës 22.08.2023 dhe Marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.2/2024 të datës 08.03.2024, më datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.2/2024 e datës 08.03.2024, e lidhur ndërmjet të dëmtuarit E.R. H. nga fsh. Hajvali, Komuna e Prishtinës dhe të pandehurit A. I. A. nga fsh.Parallovë, komuna e Novobërdës, përkitazi me Aktakuzën PP.II.nr.1286/2023, të datës 22.08.2023.

II. H U D H E T aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1286/2023, e datës 22.08.2023 dhe

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit **A. I. A.**, i lindur më 20.01.1983 nga fsh. Vërbicë e Zhegovcit, tani me vendbanim në fsh.Parallovë, komuna e Novobërdës, me nr. personal 1011595525, për shkak të veprës penale: vjedhje pylli nga neni 349 parag. 1 të KPRK-së, *pasi që në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.*

I dëmtuari E.R.H. nga fsh. Hajvali, Komuna e Prishtinës, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1286/2023, të datës 22.08.2023, ka propozuar që ndaj të pandehurit A.I.A. nga fsh. Parallovë, Komuna e Novobërdës, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: vjedhje pylli nga neni 349 parag. 1 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata, pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se në këtë çështje penale duhet hedhur aktakuzën e lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, si dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurit A. A. nga fsh.Parallovë, kom. Novobërdës, ngase më datë 08.03.2024, në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.

I dëmtuari E.R.H. nga fsh. Hajvali, Komuna e Prishtinës, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, bazuar në nenin 229, paragrafi 4, të Kodit të Procedurës Penale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2023:185309, 22.04.2024

G j y q t a r i

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.